

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **Nr.prok. 622-26-2870-1-2-1**
Nr.brend.

Sa i përket tenderit për **Furnizim me veshëmbathje për shtëpinë rezidenciale, shtëpinë e pleqëve dhe shtëpinë emergjente të fëmijëve.**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

”RIMI ALTEX” Shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Deshmoret e kombit

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

+383 44 164 991

(Numri Telefonit)

70000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Trim Goga

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

rimi-altex@hotmail.com

(Adresa elektronike)



(Nënshkrimi dhe)

07.08.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi per kontrate 28.04.2026
- Afati i fundit per dorezim te tenderit 20.05.2026 ne ora 14.00H
- Njoftimi i AK .-B58 Njoftimi per dhenje te kontrates 28.07.2026
- Kriteret e Dhenies se tenderit:Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

- Me datën 02.08.2026 nepermjet portalit të KRPP-se kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim, AK me datën 03.08.2026 na kthen Vendimin dhe Kërkesën tone për Rishqyrtim e refuzon si të pabazuar. Në Vendimin e Kërkesë për Rishqyrtim AK shkruan: “Pas shqyrtimit të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit, Autoriteti Kontraktues konstaton se kërkesa është e pabazuar në tërësi. Në mbështetje të nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues i ka dërguar operatorit ekonomik kërkesë për sqarim me qëllim të plotësimit dhe qartësimit të dokumentacionit të dorëzuar për referenca pasi që të njëjtat kanë qenë të pa lexueshme. Përkundër kësaj mundësie, edhe pas përgjigjes së dorëzuar, operatori ekonomik nuk ka arritur ta përmbushë kushtin e referencave, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk dëshmon realizimin e kontratave në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, gjë që edhe në kërkesën për rishqyrtim janë dorëzuar dokumente të cilat përseriten ka dy here Brenda kërkesës për rishqyrtim. Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk i ka përmbushur kriteret e kualifikimit dhe pretendimi ankimor refuzohet si i pabazuar.*

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Vlersimi i aktivitet të prokurimit është në kundërshtim me Ligjin prokurimit Publik,

- Shkelja e nenit 1-Qellimi i LPP-se te amandamentuar*
- Shkelja e nenin 7- Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP të amandamentuar*
- Shkelja e nenin 59 Ekz. Vler. dhe Krah. i Tenderëve te LPP te amandamentuar*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shoqëria "RIMI ALTEX" Shpk me seli në Ferizaj (me tej: Kerkuesi), brenda afatit ligjor të paraparë më dispozitën e Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 për ANKESE , respektivisht, brenda afatit të lënë për ANKESA paraqet këtë:

ANKESË

per shkak te:

- Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike*
- Aplikimit te gabuar te te drejtes materiale*

Më të cilin Kerkese Kerkuesi godet Vendimin e AK per shperblim me kontrate OE , si dhe godet vendimin per tenderuesin e eliminuar si dhe

Propozon që

Kerkesen e paraqitur nga Kerkuese ta MIRATOJ si të bazuar në Ligj, Vendimin per shperblim me kontrate ta ABROGOJ, respektivisht, ANULOJ –Njoftimin per tenderuesin e eliminuar ta ANULOJ dhe AK te vazhdon me tutje me proceduren e prokurimit per projektin e lartepermendur.

I. GJENDJA FAKTIKE

Operatori Ekonomik **rimi-ALTEX Sh.P.K.** ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit të lartcekur dhe ka dorëzuar ofertën në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Sipas Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë realizimin e projekteve të natyrës së kontratës gjatë tri viteve të fundit, me vlerë minimale prej **180,000.00 €**, të dëshmuara përmes listës së projekteve, referencave, kontratave, procesverbaleve të pranimit ose dokumenteve të tjera që dëshmojnë realizimin e furnizimeve.

Në ofertën e dorëzuar, Kompania e jone ka dorëzuar një liste të kontratave së bashku me kontratat e cilat kanë tejkaluar mbi 1,000.000.00€ mirepo nuk i kemi prezentuar të gjitha dëshmit dhe referencat.

Gjatë fazës së vlerësimit, Autoriteti Kontraktues, duke vepruar sipas nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, ka kërkuar nga të gjithë OE të cilat kanë aplikuar në këtë procedurë për sqarim të tenderave dhe për të gjithë ka qenë kërkesa e njëjta që të prezentohen dëshmit e realizimit të kontratave.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, më **10.06.2026**, Kompania e jone e ka dorëzuar dokumentacionin mbështetës, përfshirë:

- E kemi perserit Kontratën nr. **8380**, datë **03.12.2024**, të lidhur me **KEK sh.a.**, me vlerë kontraktuale prej **911,308.13 €**; (LOT-3 dhe LOT-5)
- tabelën përmbledhëse të realizimit të furnizimeve sipas kësaj kontrate;
- pesëmbëdhjetë (15) fatura tatimore;
- fletëdërgesat përkatëse;
- dëshmitë e pagesave;
- si dhe dokumentacion mbështetës për kontratat të tjera të deklaruara në listën e referencave.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se vetëm nga kontrata nr. 8380 me KEK sh.a. ishin realizuar furnizime në vlerë prej **326,671.70 €**, shumë që tejkalon me **146,671.70 €** pragun minimal prej **180,000.00 €** të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Pavarësisht dokumentacionit të dorëzuar, Autoriteti Kontraktues me Njoftimin mbi Vendimin (B58), datë 28.07.2026, e ka eliminuar ofertën e Ankuesit me arsyetimin se nuk janë dorëzuar dëshmi që vërtetojnë realizimin e kontratave të natyrës së ngjashme. Po ashtu, me vendimin e datës 03.08.2026 ka refuzuar si të pabazuar edhe Kërkesën për Rishqyrtim.

Ankuesi konsideron se të dy këto vendime janë nxjerrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe nuk mbështeten në një analizë të plotë dhe të arsyetuar të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së vlerësimit.

II. SHKELJA E DETYRIMIT PËR ARSYETIMIN E VENDIMIT

Në B42 Letren standard për tenderuesin e eliminuar, Autoriteti Kontraktues tre OE I rendit duke konstatuar Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertave, është konstatuar se operatorët ekonomik NP Emard Sankos shpk dhe Rimi-Alex shpk **nuk kanë dorëzuar dëshmi referenca që vertetojnë realizimin e kontratave të natyrës së ngjashme** sipas kërkesave të percaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Për këto arsye ofertat e tyre nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit dhe eliminohen nga procedura e metejshme e vlerësimit.

Po ashtu, edhe në vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk i është përgjigjur pretendimeve konkrete të Ankuesit, por vetëm ka përsëritur të njëjtin konstatim të përgjithshëm se kriteri nuk është përmbushur si vijon: Gjatë fazës së vlerësimit është konstatuar se Operatori Ekonomik nuk ka dorëzuar në listen e referencave dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë realizimin e kontratave të natyrës së ngjashme sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Në asnjërin prej dy vendimeve nuk specifikohet:

- cila kontratë nuk është pranuar;
- cila referencë nuk është konsideruar e vlefshme;
- cila faturë, fletëdërgesë apo dëshmi pagese nuk është marrë në konsideratë;
- për çfarë arsye dokumentacioni i dorëzuar nuk është konsideruar i mjaftueshëm për të provuar realizimin e kontratave të natyrës së ngjashme.

Nëse Autoriteti Kontraktues konsideronte se ndonjë nga dokumentet e dorëzuara nuk përmbushte kërkesat e Dosjes së Tenderit, ai kishte detyrimin të identifikonte konkretisht dokumentin përkatës dhe të jepte arsyet faktike dhe juridike për mospranimin e tij. Mungesa e një analize të tillë e bën vendimin të paverifikueshëm dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe vendimmarrjes së arsyetuar.

Për këtë arsye, Ankuesi konsideron se vendimi për eliminimin e ofertës, si dhe vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, janë marrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe duhet të anulohen.

III. KONSTATIMI I GABUAR I GJENDJES FAKTIKE

Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se Operatori Ekonomik RIMI-ALTEX Sh.P.K. nuk ka dëshmuar realizimin e kontratave të natyrës së ngjashme sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Ky konstatim nuk qëndron përballë dokumentacionit të dorëzuar nga Ankuesi dhe nuk pasqyron gjendjen faktike të krijuar gjatë procedurës së vlerësimit.

Në përgjegjejen ndaj kërkesës së AK për sqarim të tenderit me datën 10.06.2026, kompania e jone ia ka dërguar një tabelë vetëm për kontratën e KEK-ut që ka qenë për 2 lote në vlerë **326,671.70 € të realizura**; dhe një tabelë tjetër me disa AK në vlerë **164,632.20 €** (atyre tabelave I janë bashkangjitur: fletedërgesa e mallit, faturat e dorëzuara si dhe dëshmitë e fletepagesave nga pasqyrat Bankare. (Në pasqyrat bankare secila pagesë është e nënvizuar kuartet))

Në veçanti, për **Kontratën nr. 8380, datë 03.12.2024**, të lidhur me **KEK sh.a.**, me vlerë kontraktuale prej **911,308.13 €**, Ankuesi ka dorëzuar:

- kontratën;
- tabelën përmbledhëse të realizimit të furnizimeve;
- pesëmbëdhjetë (15) fatura tatimore;
- fletëdërgesat përkatëse;
- dëshmitë e pagesave.

Nga këto dokumente rezulton se deri në momentin e dorëzimit të sqarimeve sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues ishin realizuar furnizime në vlerë prej **326,671.70 €**, shumë që tejkalon dukshëm vlerën minimale prej **180,000.00 €** të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Përveç kësaj kontrate, Ankuesi ka paraqitur edhe dokumentacion mbështetës për kontrata të tjera të realizuara me institucione publike dhe subjekte private, me vlerë të përgjithshme prej **164,632.20 €**, të mbështetura me kontrata, referenca, fatura dhe dokumente të tjera përkatëse. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka analizuar asnjë nga këto prova dhe nuk ka identifikuar asnjë dokument konkret që e konsideron të papranueshëm ose të pamjaftueshëm.

Në vendimet e kontestuara mungon çdo analizë lidhur me:

- vlerën e kontratave që janë marrë në konsideratë;
- dokumentet që eventualisht nuk janë pranuar;
- arsyet faktike dhe juridike për mospranimin e tyre.

Për pasojë, përfundimi se Ankuesi nuk ka përmbushur kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional nuk mbështetet në një analizë objektive të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së prokurimit, por paraqet një konstatim të përgjithshëm dhe të paargumentuar.

Në këto rrethana, Ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike, duke mos vlerësuar provat e dorëzuara dhe duke nxjerrë një vendim që nuk mbështetet në faktet e administruara gjatë procedurës.

Si rrjedhojë e kësaj AK:

1. Nuk ka arsyetuar vendimin për eliminimin e ofertës.
2. Nuk ka analizuar dokumentacionin e dorëzuar nga Ankuesi.
3. Nuk ka treguar se cilat dokumente nuk i pranon.
4. Nuk ka shpjeguar pse nuk e pranon kontratën me KEK sh.a.
5. Nuk ka bërë përlllogaritje se sa është vlera e referencave që ai i konsideron të pranueshme.
6. Nuk ka dhënë përgjigje konkrete ndaj pretendimeve të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.
7. Është kufizuar në konstatime të përgjithshme, pa analizë faktike dhe juridike.

Ne baze te Kontrates nr. **8380** date 03.12.2024 jane kryer keto furnizime sipas fletedergesave, faturave dhe pagesave

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Numri i kontrates Data e kont.	Nr.Fatures-Fletdergesa	Data	Vlera e fatures	Paguat nga AK		
						DATA	Vlera	Faqe ne skedar PDF(nenvizuara)
1.	KEK sha	8380 /03.12.2024	6/25	06.02.2025	79,296.00€	19.03.2025	79,296.00€	153
2.	KEK sha	8380 /03.12.2024	14/28	14.02.2025	24,426.00€	26.03.2025	24,426.00€	153
3.	KEK sha	8380 /03.12.2024	19/25	21.02.2025	4,236.20€	08.04.2025	4,236.20€	154
4.	KEK sha	8380 /03.12.2024	20/25	21.02.2025	21,240.00€	05.05.2025	21,240.00€	154
5.	KEK sha	8380 /03.12.2024	25/25	06.03.2025	33,700.80€	18.04.2025	33,700.80€	138
6.	KEK sha	8380 /03.12.2024	34/25	24.03.2025	449.58€		449.58€	
7.	KEK sha	8380 /03.12.2024	16/25	19.02.2025	14,160.00€	08.04.2025	14,160.00€	153
8.	KEK sha	8380 /03.12.2024	17/25	19.02.2025	16,590.80€	08.04.2025	16,590.80€	154
9.	KEK sha	8380 /03.12.2024	28/25	12.03.2025	6,783.70€		6,783.70€	
10.	KEK sha	8380 /03.12.2024	29/25	12.03.2025	1,787.00€	18.04.2025	1,787.00€	
11.	KEK sha	8380 /03.12.2024	26/25	07.03.2025	9,223.47€	18.04.2025	9,223.47€	137
12.	KEK sha	8380 /03.12.2024	11/25	13.02.2025	10,119.33€	26.03.2026	10,119.33€	153
13.	KEK sha	8380 /03.12.2024	1/26	30.01.2026	22,656.00€	18.03.2026	22,656.00€	161
14.	KEK sha	8380 /03.12.2024	11/26	01.04.2026	32,836.80€	15.05.2026	32,836.80€	164
15.	KEK sha	8380 /03.12.2024	15/26	10.04.2026	49,086.82€			
TOTAL:					326,671.70 €			

IV. ZBATIMI I GABUAR i nenit 72 te LPP-se-

Autoriteti Kontraktues, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, duke u mbështetur në nenin 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i është drejtuar Operatorit Ekonomik RIMI-ALTEX Sh.P.K. me kërkesë për sqarim, përmes së cilës ka kërkuar dorëzimin e dëshmimeve të referencave dhe kontratave sipas listës së referencave të paraqitura në ofertë, me arsyetimin se një pjesë e dokumenteve të skanuara nuk ishin të lexueshme.

Është me rëndësi të theksohet se Autoriteti Kontraktues **nuk ka kërkuar dorëzimin e kontratave të reja, referencave të reja apo krijimin e një kapaciteti të ri teknik dhe profesional**. Kërkesa e tij kishte karakter ekskluzivisht sqarues dhe kishte për qëllim mundësimin e verifikimit të dokumenteve që tashmë ishin pjesë e ofertës.

Në përputhje me këtë kërkesë, më datë **10.06.2026**, Operatori Ekonomik dorëzoi të gjithë dokumentacionin e kërkuar në formë të lexueshme, duke përfshirë:

- kontratat e deklaruara në ofertë;
- faturat tatimore;
- fletëdergesat;
- dëshmitë e pranimit të furnizimeve;
- dëshmitë e pagesave;
- tabelat përmbledhëse që lidhin kontratat me furnizimet konkrete, faturat dhe pagesat.

Për kontratën Nr. 8380, datë 03.12.2024, të lidhur me KEK sh.a., Operatori Ekonomik dorëzoi një përmbledhje të detajuar të furnizimeve të realizuara, e cila dëshmonte se deri në atë fazë ishin realizuar furnizime në vlerë prej 326,671.70 €, të mbështetura me dokumentacion përkatës.

Përveç kësaj, janë dorëzuar edhe dëshmi për kontrata të tjera të natyrës së njëjtë ose të ngjashme, të realizuara me autoritete kontraktuese dhe operatorë të tjerë ekonomikë, të mbështetura me referenca, kontrata, fatura dhe dëshmi pagesash.

Megjithatë, nga përmbajtja e Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58), si dhe nga vendimi mbi Kërkesën për Rishqyrtim, nuk rezulton se ky dokumentacion është analizuar në mënyrë individuale dhe objektive.

Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar asnjë dokument konkret të dorëzuar sipas kërkesës për sqarim që e konsideron të papranueshëm, të pavlefshëm apo të pamjaftueshëm. Gjithashtu, nuk ka shpjeguar përse faturat, fletëdërgesat, dëshmitë e pagesave dhe dokumentet e tjera nuk provojnë realizimin e kontratave të deklaruara.

Në këto rrethana, krijohet përshtypja se kërkesa për sqarim është trajtuar vetëm si një veprim formal procedural, ndërsa dokumentacioni i dorëzuar në përgjigje të saj nuk është bërë objekt i një vlerësimi real dhe substancial.

Një qasje e tillë bie ndesh me vetë qëllimin e nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili synon t'i japë Autoritetit Kontraktues mundësinë të qartësojë dhe verifikojë dokumentacionin e dorëzuar, e jo të kërkojë sqarime që më pas të mos merren fare në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit.

Për rrjedhojë, Ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 72 të LPP-së, duke mos i vlerësuar provat e dorëzuara në përgjigje të kërkesës për sqarim dhe duke nxjerrë një vendim që nuk pasqyron rezultatin e procesit të verifikimit të dokumentacionit.

V. SHKELJA E PARIMEVE THEMELORE TË PROKURIMIT PUBLIK

Veprimet e Autoritetit Kontraktues në këtë procedurë nuk janë në përputhje me parimet themelore të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik, veçanërisht me parimin e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe përdorimit racional të fondeve publike. Ankuesi ka paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kapacitetit teknik dhe profesional, ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret për mospranimin e këtij dokumentacioni. Një vendimmarrje e tillë nuk garanton transparencën e procedurës dhe cenon të drejtën e Operatorit Ekonomik për një vlerësim objektiv dhe të arsyetuar.

Për më tepër, oferta e Ankuesit ka qenë në vlerë prej 68,290.00 €, ndërsa oferta e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës është 85,660.00 €, që paraqet një diferencë prej 17,370.00 €.

Megjithëse çmimi më i ulët nuk është kriter i vetëm për dhënien e kontratës, në rastin konkret kriteri i dhënies ka qenë "**Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**". Për këtë arsye, para eliminimit të ofertës së Ankuesit, Autoriteti Kontraktues kishte detyrimin që të siguronte një proces vlerësimi të plotë, objektiv dhe të arsyetuar, veçanërisht kur eliminimi i ofertës më të ulët sjell si pasojë përzgjedhjen e një oferte me kosto më të lartë për fondet publike.

Në mungesë të një analize konkrete të dokumentacionit dhe të një arsyetimi të mjaftueshëm për eliminimin e ofertës së Ankuesit, vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk është në përputhje me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik dhe, si i tillë, nuk mund të mbetet në fuqi.

VI. KËRKESA

Duke u bazuar në nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar, si dhe në argumentet faktike e juridike të paraqitura në këtë ankesë, **i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që:**

1. **Ta aprovojë si të bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik RIMI-ALTEX Sh.P.K.;**
2. **Ta anulojë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58), datë 28.07.2026;**
3. **Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues, datë 03.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim;**
4. **Ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, me detyrim që Autoriteti Kontraktues të bëjë një vlerësim të plotë, objektiv dhe të arsyetuar të të gjithë dokumentacionit të dorëzuar nga Ankuesi, në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vendimi i kundërshtuar i Autoritetit Kontraktues i ka shkaktuar dhe vazhdon t'i shkaktojë Operatorit Ekonomik RIMI ALTEX. dëme materiale, pasi është privuar nga mundësia reale për t'u shpallur fitues dhe për të realizuar kontratën, Pasi administrativisht dhe teknikisht jemi te përgjegjshem.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*